



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, 17 nëntor 2009, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mursel Halijli, Teuta Hadri, Gjylnaze Syla, Qamile Morina, Flora Brovina, Bujar Bukoshi dhe Nurishahe Hulaj.

Të pranishëm: Nga Ministria e Shëndetësisë; Fatime Aliu dhe Flakron Sylejmani, Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhiaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore, nga KDI; Rrezarta Ahmeti, nga OSBE – ja; Lejla Selimi, nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/1-36;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/1-36

Sadik Idriz – Tha se komisioni ka formuar grupin punues i cili është marruar me shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin. Propozoj që në këtë mbledhje të shqyrtohen propozimamendamentet e grupit punues, ndërsa në mbledhjen radhës të votohen përfundimisht ato. Fjalën i dha raportueses së grupit punues, deputetes Nurishahe Hulaj.

Nurishahe Hulaj, raportuese e grupit punues- Tha se grupi punues ka propozuar që të mbahet një dëgjim publik lidhur me këtë ligj i cili edhe është mbajtur, ka mbajtur disa takime dhe komisionit i ka propozuar amendamentet të cilat do t'i shqyrtoj sot. Propozimamendamentet grupi punues i ka bërë në bazë të të dhënave të cilat i ka mbledhur nga të gjithë të interesuarit të cilët kanë marrë pjesë në dëgjim publik. Disa çështje janë lënë që të diskutohen në komision.

Gjylnaze Sylja – Tha se gjatë shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin, ne kemi kuptuar se do të bëhet një Ligj i posaçëm për prodhimin e duhanit, eksportimin e duhanit etj. Kjo na ka ndihmuar që të orientohemi që kompetencat të cilat kanë të bëjnë sidomos me shëndetin publik të specifikohen si kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë. Po ashtu ne si grup punues kemi propozuar që kryesues i Këshillit Profesional të jetë ministri i Ministrisë së Shëndetësisë. Kemi propozuar një paragraf të ri me të cilin kemi ndaluar pirjen e duhanit në të gjitha mjetet e transportit publik. Afatin për vendosjen e shenjzimeve e kemi zgjatur në 12 muaj - e jo 6 muaj siç ka propozuar sponzoruesi - sepse duhet t'u japim kohë prodhuesve dhe importuesve të duhanit për vendosjen e këtyre shenjzimeve. Inspektorati i punës ka kërkuar që obligimi i paraparë nga “neni 9” të mos jetë obligim për inspektoratin e punës si dhe kemi pasur disa propozime edhe nga Filip Moris, megjithatë ne si grup punues kemi vendosur që këto çështje të mbesin si në ligj, sepse në radhë të parë duhet të marrim për bazë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, por megjithatë lidhur me këtë mund të vendos komisioni. Domethënë kryesisht propozimet e grupit punues kanë të bëjnë me specifikimin e autoritetit përkatës – përgjegjës.

Teuta Hadri – Tha se në dëgjim publik është vendosur që dikush nga raportuesit do të komunikoj me Qeverinë sa i përket buxhetit për këtë ligj. Janë ndarë 880 mijë euro, por kjo kosto ka pasur ndryshim, sepse me këtë Projektligj është paraparë edhe laborator. Ne akoma nuk e kemi të qartë nëse Buxheti i Kosovës do të mbulojë këtë kosto për laborator. Kjo çështje duhet të qartësohet. Propozoj që përveç prodhimit të duhanit në këtë ligj duhet të përfshihet edhe kultivimi i duhanit, sepse kur kultivohet duhani koncentrimi i helmit është problem publik i shëndetësisë. Duhet të caktohet një fond për këtë, sepse do të punësohen punëtorët që do të bëjnë kultivimin.

Gjylnaze Sylja – Lidhur me buxhetin tha se Komisioni ka ftuar përfaqësuesit e Departamentit të Buxhetit, por nuk i janë përgjigjur ftesës. Propozoj që kryetari i komisionit t'i bëjë një ftesë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të sqarojnë këtë çështje, sepse është çështje kyçe. Sa i përket kultivimit të duhanit, meqenëse po bëhet ligj

i veçante, atëherë ne kemi konsideruar që më mirë një ligj i veçante, sepse do të specifikoj posaçërisht çështjen e kultivimit.

Nurishahe Hulaj – Tha se MTI-ja ka propozuar që nga Ligji për duhanin të hiqet neni 8 dhe 9, sepse këto nene duhet të jenë pjesë e Ligjit për përpunimin dhe prodhimin e duhanit. Bëri prezantimin e amendamenteve të grupit punues.

Sadik Idriz – Lidhur me propozimin për të ftuar në takim përfaqësuesit e MEF tha se, mund të ftojme përfaqësuesit e kësaj ministrie, por kjo është më shumë çështje e Qeverisë dhe njëherësh ky ligj është miratuar në parim.

Rita Hajzeraj – Meqenëse ky Projektligj së bashku me amendamente e komisionit do të shqyrtohet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, atëherë ne nuk duhet të merremi më buxhet dhe nëse komisioni për buxhet konstaton se ky Projektligj ka implikime buxhetore, atëherë ne kot e miratojmë këtë ligj. Edhe MSh-ja mund të na jap përgjigje se si ka menduar të zbatoj këtë Projektligj përdërisa nuk i ka të sigurt buxhetin.

Flora Brovina – Ne duhet të bëjmë përpjekje që të sqarojmë çështjen e buxhetit dhe ne mund të kërkojmë që MEF-i të na dërgoj me shkrim përgjigje nëse janë paraparë mjetet për laborator dhe për këtë ligj në përgjithësi. Çështja e kultivimit të duhanit është shumë me rëndësi dhe kjo çështje ka të bëjë edhe me shëndetin. Pavarësisht që do të bëhet ligj i ri, ky ligj do ta ndihmoj dhe do ta plotësoj ligjin që do të nxirret për prodhimin dhe kultivimin e duhanit.

Mursel Halijli – Tha se ne si komision duhet të koncentrohemi në propozimamendamentet e grupit punues.

Nurishahe Hulaj – Lidhur me amendamentin e parë tha se ka propozuar që fjala preventive në tërë tekstin e ligjit të zëvendësohet me fjalën parandaluese.

Sadik Idriz - Tha kjo nuk është diçka përmbajtjesore dhe nëse pranohet ky amendament do të jetë vetëm për versionin në gjuhën shqipe, sepse në gjuhën serbe mbetet e njëjtë.

Nurishahe Hulaj – Tha se grupi punues ka propozuar amendamentin e dytë me qëllim që të specifikohet përgjegjësia e organit të paraparë me nenin 4 të Ligjit. Ne kemi propozuar që ky organ të jetë Ministria e Shëndetësisë.

Rita Hajzeraj – Tha se Inspektorati sanitar me Ligjin për ushqimin kalon në Agjensionin për ushqimin, domethënë nuk është më në Ministrinë e Shëndetësisë.

Gjylnaze Sylja – Nëse ne nuk ndërhyjmë në këtë nen atëherë ju siguroj që ky nen nuk do të zbatohet sepse nuk është i specifikuar dhe secili do t'i ik përgjegjësive që dalin nga ky nen.

Flora Brovina – Propozoj që të përkrahet teksti në ligj “*qeveria me mekanizmat e veta*”, sepse ne në këtë mënyrë e kemi adresën se kujt do t'i drejtohem në rast moszbatimi të kësaj dispozite.

Sadik Idriz – Tha se paragrafët e tjera e kanë adresuar përgjegjësinë te Ministria e Shëndetësisë, andaj nuk e shoh të arsyeshme që së pari të flasim për Qeverinë dhe organet kompetente e në paragrafët në vijim t'i referohemi Ministrisë së Shëndetësisë. Në nenin 4 të Ligjit flitet për testim të duhanit, kjo nuk ka të bëjë me inspektoratin sanitar.

Rita Hajzeraj – Tha se duhet të përkrahet propozimamendamenti, sepse nëse e përkrahim tekstin e ligjit, atëherë ne nuk kemi adresë të saktë për t'u drejtuar në rast moszbatimi të kësaj dispozite. Atëherë Ministria e Shëndetësisë duhet të na informoj nëse kanë paraparë një mekanizëm tjetër për mbikëqyrjen e kësaj dispozite.

Mursel Halilji – Nëse e lexojmë gjithë nenin 4, atëherë është logjike që të jetë Ministria e Shëndetësisë. Pasi që edhe paragrafët vijuese 4.4, 4.5 kanë të bëjnë me testimin, atëherë duhet që në gjithë nenin 4 të jetë Ministria e Shëndetësisë.

Gjylnaze Sylja – Tha se neni 4.1 ka të bëjë me përbërësit e duhanit, pasi që testimin e bënë laboratorit i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, atëherë duhet të jetë Ministria e Shëndetësisë organi përgjegjës për zbatimin e këtij neni.

Nurishahe Hulaj – Tha, grupi punues ka propozuar që në nenin 4 të Projektligjit pas fjalës „tejudkshëm” shtohet fjalia „afati i zbatimit 12 muaj pas hyrjes së ligjit në fuqi. Mirëpo, grupi punues mendon se ky amendament është i panevojshëm pasi që ky afat është paraparë edhe në nenin 7 të Projektligjit.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstatoi se komisioni u pajtua që ky amendament të mos përkrahet, pasi që afati kohor i paraparë me këtë amendament është i rregulluar me nenin 7 të Projektligjit.

Nurishahe Hulaj – Neni 11.3 i Ligjit - Amendamenti 6 - është propozuar me qëllim që kryesues i Këshillit të jetë ministri i shëndetësisë. Në ato pjesë të Projektligjit dhe të Ligjit “*organ kompetent*” ne e kemi definuar saktë “*Ministria e Shëndetësisë*”, sepse kjo ministri është kryesisht përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit dhe për zbatimin e këtij ligji.

Mursel Halilji – Tha se pajtohet që kryesuesi i këshillit të jetë në nivel ministri, por nëse duhet lënë mundësia për zëvendës, atëherë kjo duhet të parashihet me amendament.

Rita Hajzeraj – Tha se fjala është për kryesuesin e Këshillit Profesional, ne duhet të kemi parasysh që ministri mund të mos jetë profesional.

Gjylnaze Sylja – Tha se politikat shëndetësore i bënë ministri dhe nuk ka rëndësi a është mjek apo jo. Ky do të jetë një mekanizëm shumë i mirë për Ministrinë e Shëndetësisë.

Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesi konstatoi se stafi mbështetës do të bëjë spastrimin e tekstit në pajtim me propozimet e ditës së sotme, ndërsa komisioni do të votoi në mbledhjen e radhës lidhur me propozim amendamentet e shqyrtuara lidhur me Ligjin për duhanit.

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me atë se buxheti i paraparë për komision nuk mund të shfrytëzohet për udhëtime jashtë vendit. Atë buxhet mundemi ta shfrytëzojmë vetëm brenda Kosovës për nevojat e komisionit.

Projektin të cilin e kemi pasur për udhëtim në Slloveni, “FES” nuk ka mundësi të na mbështes për këtë vit, ndoshta për vitin e ardhshëm do ta bëjë këtë.

Qamile Morina- Ne duhet të kemi kërkesë zyrtare me shkrim. Ne duhet të dimë takimet lidhur me monitorimin e ligjeve - a llogariten në këtë buxhet të komisionit apo jo. Neve na thuhet se ky buxhet nuk mund të shfrytëzohet për këtë apo atë, punë këto të cilat janë në të mirë të komisionit, me ligjet që ne do t'i kemi, atëherë këtë duhet ta kemi me shkrim në mënyrë që ne të shohim mundësit tona për ankesë të mëtutjeshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 40

E hartoi
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz